



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.36.1- 2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PARTESHIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Parteshit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Astrit Bllaca, i mbështetur nga Faik Thaqi (Udhëheqës Ekipi), dhe Millosh Petroviç.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	28


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Parteshit për vitin 2015 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 19.11.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih Shtojcën 1 të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


“Opinion i kualifikuar me Theksim të Çështjes” sepse tek neni 13 - Raporti për ekzekutimin e buxhetit, në vend të buxhetit fillestar kishte paraqitur buxheti final, ndërsa në vend të buxhetit final ishin prezantuar shumat e alokuara. Poashtu, ka paqartësi në prezantimin e plotë të vlerës së pasurive, të arkëtueshmeve dhe të hyrave vetjake.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi te nën kapitulli 1.2 i këtij raporti .

Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm i vendosur nga komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha, por dobësitë ende janë të pranishme në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, do ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E PARTESHIT

OPINIONI I KUALIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Parteshit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Parteshit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion të kualifikuar

Në Pasqyrën e Krahasimit të Shumave Buxhetore dhe Aktuale - në shtyllën buxheti fillestar, komuna ka prezantuar buxhetin final në vlerë 1,040,434€, ndërsa sipas tabelës buxhetore duhet të jetë 809,397€. Diferenca prej 231,037€, ka ndikuar që buxheti fillestar të mbivlerësohet. Ndërsa vlerat tek shtylla e buxhetit final janë nënvlerësuar për 40,383€, sepse aty ishin paraqitur shumat e alokuara të buxhetit.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion kualifikuar.

Theksimi i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se tokat e, nuk janë të regjistruara në regjistrin kontabël SIMFK si dhe nuk janë prezantuar në PVF. Kjo ka ndikuar që pasuritë janë nënvlerësuar për vlerën e tokave. Po ashtu, pasuritë nën 1,000€ euro nuk janë shpalosur në PVF. Opinioni ynë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - (SNKSP) Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshëm të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 19.11.2015, është identifikuar një rrezik për PVF-të dhe si i tillë mund të rezultojë në theksim të çështjes. Rreziku ka të bëjë me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurisë. Komuna kishte formuar komision për inventarizimin e pasurisë por komisioni ende nuk e kishte përfunduar punën. Tokat e komunës nuk janë të regjistruara në regjistrin kontabël SIMFK si dhe nuk janë prezantuar në PVF. Poashtu pasuritë nën 1,000€ nuk janë të regjistruara në sistemin e e-pasurisë, apo në ndonjë format tjetër. Ky rrezik është materializuar sepse nga menaxhmenti nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për ta adresuar rrezikun e paraqitur.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e buxhetit;
- Nëse PVF janë nënshkruar nga ZKF dhe Kryetari;
- Nëse PVF janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal.

Sa i përket kornizës për raportim të jashtëm, ne nuk kemi ndonjë vërejtje. Por, ne kemi identifikuar gabime dhe pasaktësi në informatat e prezantuara në Pasqyra financiare. Pasaktësitë dhe gabimet e identifikuara kanë të bëjnë me çështjet në vijim:

- Në Pasqyrën e Krahasimit të Shumave Buxhetore dhe Aktuale - në shtyllën buxheti fillestar, komuna ka prezantuar buxhetin final në vlerë 1,040,434€, ndërsa sipas tabelës buxhetore duhet të jetë 809,397€. Diferenca prej 231,037€, ka ndikuar që buxheti fillestar të mbivlerësohet;
- Ndërsa, vlerat e buxhetit final janë nënvlerësuar për 40,383€, sepse aty është paraqitur buxheti i alokuar. Po ashtu, tek kolona e shpenzimeve, mallrat dhe shërbimet janë nënvlerësuar për 4,552€;
- Në Shënimin 32 – Pasuritë nën 1000€, nuk ishin shpalosur fare;

- Në Shënimin 35 - Të arkëtueshmet ishin nënvlerësuar për shumën 11,325€;
- Në Shënimin 36 - Të hyrat vetjake janë mbivlerësuar për 6,000€;
- Në Shënimin 37 - Tek harmonizimi i ndarjeve buxhetore, nuk ishin shpalosur përshtatjet e buxhetit sipas vendimeve të Qeverisë; dhe
- Në Shënimin 39 - Plani për implementimin e rekomandimeve nga viti i kaluar nuk ishte plotësuar.

Të gjeturat më lartë tregojnë PVF-të nuk ishin përgatitur me kujdesin e duhur, dhe si të tilla, përmbajnë mangësi informatash, por edhe gabime, të cilat kanë ndikuar opinionin e auditimit.

Duke pasur parasysh të gjeturat e lartpërmendura, mund të konkludojmë se Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e pasaktë për çështjet e cekura më lartë.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rrezikun domethënës për pasuritë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo është një tregues se sa menaxhmenti është i përkushtuar në përmirësimin e proceseve ekzistuese dhe kontroleve të brendshme..

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e mundësisë për angazhimin e auditivit të brendshëm nga Ministria e Financave; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë të qeverisjes vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit duhet të konsiderohen.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të Komunës së Parteshit ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Komuna nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, katër (4) rekomandime janë implementuar; dy (2) janë në proces të adresimit dhe gjashtë (6) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Raporti i auditimit të vitit 2014, ishte diskutuar edhe në Asamblenë Komunale.

Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kanë rezultuar në:

- Mos-efikasitet i vazhdueshëm në identifikim, regjistrimin e pasurisë dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare;
- Menaxhim të dobët të të hyrave vetjake; dhe
- Rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të siguroj plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve specifikon qartë masat dhe veprimet e nevojshme për të korrigjuar dobësitë dhe mangësitë e identifikuara, duke i caktuar edhe personat përgjegjës dhe afatet kohore brenda të cilave plani do të realizohet. Përparësi në trajtimin e rekomandimeve duhet të kenë çështjet që konsiderohen më të rëndësishme dhe që përmbajnë nivel të lartë rreziku.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF. Me poshtë ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të ofroj koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por të ofroj gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së si tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioritet i mesëm

E gjetura	<p>Si pjesë e auditimit tonë, ne kemi shqyrtuar disa pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me komponentët e vlerësuar. Nga çështjet e shqyrtuara kemi gjetur se:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Komuna për vitin 2015 nuk kishte strategji komunale për zhvillim ekonomik dhe sektorëve tjerë;2. Mungojnë procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut (kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1).
Rreziku	<p>Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative duke zvogëluar cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.</p>
Rekomandimi 3	<p>Kryetari duhet të sigurojë se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave.</p>

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik. Ky regjistër identifikon rreziqet potenciale ndaj të cilave ekspozohet komuna, ndikimin e tyre dhe gjasat që rreziku të materializohet.

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut – Prioritet i mesëm

E gjetura	Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka rikonfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar rreziqet të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet e duhura në rast të ndodhjes së tyre.
Rreziku	Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë mundësinë e menaxhmentit për të marrë masat dhe veprimet e duhura për reduktimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm për të evituar devijimin e proceseve nga ecuritë normale.
Rekomandimi 4	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar një listë ku rreziqet janë identifikuar sipas niveleve dhe gjasave që ato mund të ndodhin, si dhe janë parashikuar masat si kundërpërgjigje nëse ato ndodhin. Gjithashtu, përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut duhet të delegohet tek një përgjegjës i cili do të raportoj tek menaxhmenti dhe të sigurojë zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

2.5.2 Plani zhvillimor i komunës

Çështja 4 - Mungesa e planit zhvillimor – Prioritet i lartë

E gjetura	Komuna nuk posedon një plan strategjik me objektiva afatgjate ku përshkruhet qartë Vizioni dhe Misioni i cili prezanton orientimin dhe synimet e komunës në një periudhë afatmesme të zhvillimit
Rreziku	Mungesa e planit strategjik rrezikon prioritet e çështjeve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e komunës në periudha afatgjate.
Rekomandimi 5	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjate dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna ka një buxhet më rreth një milion euro, andaj nuk ka planifikuar nevojën e rekrutimit të një auditori të brendshëm, por as mundësinë e shfrytëzimit të shërbimeve të auditimit nga ndonjë entitet tjetër.

Çështja 5 - Mungesa e auditimit të brendshëm – Prioritet i Mesëm

E gjetura	Në mungesë të auditorit të brendshëm, komuna nuk ka bërë përpjekje që shërbimet e auditimit të brendshëm t'i siguroj nga bashkëpunimi me ndonjë organizatë tjetër buxhetore ose të kërkoj mbështetje nga Ministria e Financave.
Rreziku	Mungesa e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos i identifikojë dhe reagojë me kohë ndaj parregullsive dhe dobësive të kontrollit.
Rekomandimi 6	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të kërkoj kryerjen e këtij shërbimi nga Ministria e Financave ose ndonjë organizatë tjetër për vitet e ardhshme.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Komuna e kupton rëndësinë e një sistemi adekuat dhe të fortë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me prokurimin, të hyrat dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkon procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës (procedura standarde të operimit) të cilat sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve vendore, rregulloreve të brendshme dhe proceseve tjera të kontrollit.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final1	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	809,397	1,040,434	980,772	795,388	887,989
Granti i Qeverisë -Buxheti	763,013	936,105	927,967	795,388	812,088
Të bartura nga viti paraprak ²	0	55,645	46,805	0	24,357
Të hyrat vetjake ³	46,384	46,384	6,000	0	0
Donacionet e jashtme	0	2,300	0	0	51,544

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 231,037€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të Qeverisë për mbulimin e shpenzimeve si dhe bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2014. Mjetet e ndara me vendimet e qeverisë janë në vlerë 140,000€ dhe pjesa prej 35,392€, është rritja me rishikim të buxhetit.

Në vitin 2015, komuna ka përdorur 94% të buxhetit final ose 980,772€, me një përmirësim prej 8% krahasuar me vitin 2014, çka prezanton një performancë mjaft të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	809,397	1,040,434	980,772	795,388	887,988
Pagat dhe Mëditjet	750,000	783,092	783,092	650,860	626,300
Mallrat dhe Shërbimet	21,000	131,000	115,031	69,243	88,453
Shërbimet komunale	12,013	40,013	33,944	33,113	21,368
Subvencionet dhe Transferet	0	2,000	1,900	5,054	5,150
Investimet Kapitale	26,384	84,330	46,805	37,118	146,717

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit për 57,946€, realizimi i projekteve kapitale kishte ngecur për faktin se vetëm 55% të fondeve ishin shpenzuar. Nga tabela e mësipërme shihet se nga viti në vit investimet kapitale kanë pasur një trend në rënie.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	46,384	46,384	41,485	30,655	24,991

Çështja 6 - Ekzekutimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Të hyrat vetjake të realizuara në vlerë 41,485€, ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e komunës, por janë shpenzuar vetëm 6,000€. Pjesa e mbetur e të hyrave në vlerë 35,485€ së bashku me të hyrat e bartura nga vitet tjera në vlerë 8,841€, që në total janë 44,326€, janë bartur për shpenzim në vitin 2016
- Rreziku** Ekziston një mospërputhje e lartë në mes planit dhe shpenzimeve të të hyrave. Planifikimi i dobët i shpenzimeve ka ndikuar në ngecjen dhe mosrealizimin e projekteve kapitale. Kjo shpie në rrezikun që buxheti të përcillet me suficite të larta, në veçanti në pjesën që ka të bëjë me të hyrat.
- Rekomandimi 7** Çasja ndaj planifikimit buxhetor ka nevojë për përmirësime thelbësore. Para se të vendosen zërat buxhetor, komuna duhet të analizoj me kujdes dhe objektivitet se cilat projekte janë prioritare dhe cilat prej tyre kanë gjasa reale të realizohen. Procedurat e filluara me kohë (hartimi i projekteve, prokurimi, etj) janë disa nga parakushtet që projektet kapitale të realizohen sipas planit.

3.4 Prokurimi

Investimet kapitale fillestare të planifikuara për vitin 2015 ishin 26,384€, Me rishikim të buxhetit vlera e investimeve kapitale ishte rritur në 84,330€, nga të cilat ishin shpenzuar 46,805€ apo (55%).

Çështja 7 – Dobësi jo sistematike në fushën e prokurimit – Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Komuna për vitin 2015 nuk ka pasur një plan të prokurimit për faktin se nuk ka pasur të punësuar një zyrtar të prokurimit. Megjithatë, ka arritur të realizoj disa kontrata me vlera të vogla dhe të mesme.
- Furnizimi me 500 litra naftë për gjenerator në shëndetësinë sekondare është regjistruar si shpenzim i shëndetësisë primare.
- Po ashtu, komuna ka furnizuar një person fizik me 40 litra naftë për nevoja private, ndërsa i ka regjistruar si shpenzime komunale.
- Komuna kishte paguar kompaninë për sigurimin e objektit, ku vlerën 1,428€ e kishte regjistruar gabim si mirëmbajtje e automjeteve.

- Rreziku** Shmangia e procedurave për regjistrimin e shpenzimeve në kodet adekuate, dhe shpenzimet e derivateve për qëllime private, rrit rrezikun e pasqyrimin jo të drejtë të shpenzimeve dhe humbje financiare për komunën.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet ta shqyrtojë pse kërkesat e rregulloreve nuk janë zbatuar në rastet e mësipërme, dhe të implementohen kontrolle të shtuara, për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten.

Çështja 8 Ekzekutimi nga Përmbaruesi Privat - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Thesari ka ekzekutuar vendimin e përmbaruesit privat me 21.10.2015 në shumën 10,251€. Komuna me datën 15.05.2015 ka kundërshtuar në momentin që është njoftuar për ekzekutimin e pagesës me shkresën drejtuar përmbaruesit privat duke ia rikujtuar se nuk ka dëshmi për ndonjë kontratë, tender apo pranim të shërbimit. Nga dëshmitë e ofruara nga komuna vërejtëm se pranimi i shërbimit ishte nënshkruar nga ish kryetari në vitin 2013. Fatura e datës 10.03.2015 nr 1/2015 ishte e pa rregullt për faktin se vlera 725 € e llogaritur si TVSH me shkallë (9%). Faturimi ishte bërë me vonesë për 19 muaj. Të gjitha këto janë dëshmi të mjaftueshme për përmbaruesin privat të merrte vendim për mos ekzekutim të pagesës.
- Rreziku** Ekzekutimi i vendimit të përmbaruesit privat nga thesari, duke mos pasur parasysh kundërshtimin nga komuna, shton rrezikun që komunës t'i jenë zbritur fondet buxhetore në mënyrë të padrejtë.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të ndërmerr masa të nevojshme që pagesa e ekzekutuar pa pranim të shërbimeve nga ana e Thesarit, të shqyrtohet nga zyrtarët përgjegjës të Thesarit dhe ndalesa e bërë në mënyrë të padrejtë t'i rimbursohet komunës.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Komuna, sipas projeksioneve fillestare për vitin 2015 për këtë kategori kishte planifikuar shumën prej 750,000€, derisa me buxhet final kishte 783,092€, buxhet të cilin e kishte shpenzuar në shkallë maksimale 100%. Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjësve të rinj, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollet tjera shoqëruese bëhen nga Ministria e Financave, ndërsa aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje nga Asambleja Komunale.

Çështja 9 - Dobësi në paga - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Pagat e muajit prill janë nënvlerësuar për 5,839€ duke mos u regjistruar në Librin Kryesor në shumën e plotë. Listat e pagave nga të punësuarit në arsim dhe shëndetësi nuk ishin nënshkruar deri në shtator. Në asnjë shkollë nuk ka pozitë të drejtorëve. Në dy raste kemi të punësuar pa procedura të rekrutimit.
- Rreziku** Zyra e personelit nuk ka azhurnuar dosjen e personelit dhe për pasojë kanë ndodhë pagesa jo korrekte dhe të pa konfirmuara nëse ato u janë paguar personave të duhur. Mos nënshkrimi i listës së pagave rrit rrezikun që paga të marrin edhe personat që nuk janë staf i rregullt në arsim apo shëndetësi.
- Rekomandimi 10** Një shqyrtim sistematik i dosjeve të personelit duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë, brenda një periudhe të specifikuar kohore, dhe se pagesat bëhen vetëm pas konfirmimit të marrëdhënies së punës për secilin person të përfshirë në listat e pagave.

3.5.2 - Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet janë kategori e ndihmave financiare që u jepen përfituesve nga komuna pa kthim të drejtpërdrejt, në shumën e përcaktuara me rregulloren komunale. Ato kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe jo publike dhe personave fizik në nevojë. Kontrollat e zbatuara nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike. Buxheti për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2015, ishte 2,000€. Nga kjo kategori ishin shpenzuar 1,900€.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2015 ishin 41,485€, apo shprehur në përqindje rreth 90% e shumës së planifikuar. Të hyrat janë realizuar kryesisht nga tatimi në pronë dhe taksat tjera administrative. Ekziston nevoja për përmirësim në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave, për faktin se vetëm 14% e të hyrave të këtij viti janë shpenzuar.

Rekomandimet

Çështja 10 -Tatimi në Pronë - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë vitit 2015 ishin planifikuar të hyra nga tatimi në pronë për këtë vit dhe vitet e mëhershme në vlerë 24,384€. Nëse krahasojmë faturimin nga MF për këtë vit që ishte 11,384€ dhe realizimin 11,257€ duket se ka konsistencë, megjithatë ka mangësi:

- Vlera e të arkëtueshmeve është në rritje dhe ka arritur në 168,342€;
- Nuk kishte angazhim në regjistrimet e pronave të reja dhe vlerësimin e pronave ekzistuese, siç kërkohet me ligjin e tatimit në pronë, dhe nuk është e qartë baza reale e ngarkesave tatimore.

Rreziku Mungesa e evidencave të plota për ngarkesa tatimore mund të ketë si pasojë nën pagimin e tatimeve dhe mos inkasimin e të hyrave potenciale.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të zbatojë një proces regjistrimi dhe vlerësimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, për të përcaktuar bazën reale të ngarkesave tatimore, si dhe të forcojë kontrollet që borxhet e mbetura ndaj komunës të paguhen.

Çështja 11 -Taksa e Veprimtarisë - Prioritet i Mesëm

E gjetura Në territorin e komunës veprimtarinë biznesore e zhvillojnë 78 biznese të vogla. Komuna nuk ka tentuar të faturojë për vitin 2015. Sipas rregullores së brendshme po të faturon do të ishte vlera 3,775€. Pranimet nga faturimi i vitit janë në vlerë simbolike 35€ apo 1%. Në analizuar obligimet të krijuara gjatë viteve të cilat janë në rritje, dhe në fund të vitit 2015 ato arrijnë shumën 11,325€.

Komuna përmes angazhimit të inspektorëve komunal dhe faturimit me kohë ka mundur ta rrisë inkasimin nga taksa e veprimtarisë.

Rreziku Politikat e inkasimit duket të jenë të dobëta për të siguruar maksimizimin e të hyrave, e po ashtu edhe kontrollet operative nuk janë efektive. Kështu mund të kemi një nën pagim të të hyrave. Vonesat në mbledhjen e të hyrave, sjellin edhe dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve nga ky burim.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të ketë një qasje më rigoroze në trajtimin e këtyre taksave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Nevojitet një rishqyrtim i politikave ekzistuese dhe të propozohen masat e duhura që të gjitha bizneset që veprojnë në territorin e komunës, të posedojnë leje për veprimtari.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna ka bërë një progres të mirë në regjistrimin e pasurive në SIMFK, krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2014 sipas PVF ishin 67,616€ pasuri të regjistruara në Librin Kontabël, derisa në vitin 2015 ka të regjistruara 1,178,828€. Një rritje të tillë e ka shtuar vetëm regjistrimi i shtëpisë së kulturës në vlerë 899,877€.

Çështja 12 – Regjistri jo i plotë i pasurive- Prioritet i lartë

E gjetura Përkundër progresit, komuna ende nuk ka një regjistër të plotë të pasurive të prezantuar në PVF. Ne kemi ekzaminuar gjendjen e pasurive dhe konkluzioni ynë është se vlera e tërësishme e pasurive ekzistuese nuk është prezantuar në PVF-të e vitit 2015. Tokat e komunës nuk janë të regjistruara në Regjistrin e pasurive, ndërsa të njëjtat janë të evidentuara në librin e kadastrit, Gjithashtu, as pajisjet e teknologjisë informative nuk janë regjistruar.

Kryetari i Komunës kishte formuar një komision për inventarizimin e pasurive, por ky komision deri në datën e auditimit, nuk e kishte kryer punën dhe nuk dihen rezultatet e regjistrimit.

Pasuritë nën 1,000€ nuk i ka të regjistruara as në sistemin e e-pasurisë, as në ndonjë format tjetër.

Rreziku Mungesa e regjistrave të plotë të pasurive vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, madje edhe të humben dhe tjetërsohen.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj që sa më parë komisioni i caktuar të kompletoj vlerësimin dhe inventarizimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive fikse që janë në pronësi të komunës. Gjithashtu, menaxhmenti duhet të monitoroj edhe rezultatet e vlerësimit dhe të azhurnoj regjistrat e pasurisë në mënyrë sistematike.

3.7.2 Trajtimi i të Arkëtueshmeve

Komuna, bazuar në ligjin e vetëqeverisjes lokale inkason lloje të ndryshme të të hyrave vetjake. Në PVF 2015, komuna ka prezantuar si llogari të arkëtueshme vetëm Tatimin ne Pronë 168,342€.

Çështja 13 - Rritja e të arkëtueshmeve -Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Komuna kishte nënvlerësuar të arkëtueshmet për 11,325€, që janë taksa të veprimtarive afariste për tri vite, që do të thotë se ishin paraqitur në PVF në shuma më të vogla se shuma faktike.
- Rreziku** Në mungesë të evidencave të sakta dhe qasjes jo adekuate, ekziston rreziku që shumat e pa mbledhura dhe të pa raportuara të këtyre llogarive të shndërrohen në borxhe të këqija dhe si të tilla mos mblidhen kurrë.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike gjendjen e këtyre llogarive. Një analizë e detajuar që përcakton arsyet e ngecjes së inkasimit duhet të bëhet, si dhe të propozohen udhëzime të qarta dhe veprimet konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Komuna nuk ka kontrole të mira në evidentimin e obligimeve ndaj operatorëve ekonomik. Libri për pranimin e faturave (Libri i Protokollit), nuk ishte aplikuar gjatë vitit 2015. Pas rekomandimeve tona, i njëjti ka filluar të aplikohet në vitin 2016.

Çështja 14 - Obligimet e pa raportuara - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Obligimet e papaguara nuk raportohen në Thesar sipas kërkesës së rregullores së Thesarit 04/2011, si dhe nuk ka libër të evidencave se kur arrijnë faturat.
- Rreziku** Mos raportimi i obligimeve dhe evidentimi i tyre, mund ta sjellë komunën në raportime jo të drejta, vështirësi financiare dhe me mundësi potenciale për hapjen e kontesteve gjyqësore.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të sigurohet se zyrtarët financiar bëjnë regjistrimin dhe raportimin e të gjitha faturave, si dhe respektojnë afatet ligjore për pagesën e tyre. Raportet për faturat e pa paguara duhet t'i dorëzohen Ministrisë së Financave në afatet e përcaktuara.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime i materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Çështja 1 Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF	Rekomandimi 1 Prioritet i Lartë Kryetari i Komunës duhet të inicojë një analizë pse nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e rrezikut në vitin 2014 dhe të sigurojë zbatimin e tyre në PVF-të e vitit 2015. Veprimet e Kryetarit duhet në mënyrë të qartë të përcaktojnë personat përgjegjës dhe afatet kohore. Progresi kundrejt veprimeve të marra duhet të monitorohet në mënyrë sistematike			x
Çështja 2 Përgatitja e PVF – Prioritet i Lartë	Rekomandimi 2 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2015 përfshin një rishikim të detajuar të menaxhmentit ndaj draft-pasqyrave, me fokus të veçantë mbi fushat me rrezik të lartë që janë identifikuar viteve paraprake. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në të gjitha draft PVF-të janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			x
Çështja 3 Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i Lartë	Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2013 dhe ato të vitit 2014, i rishikuar, të përcaktojë një afat të qartë kohor të implementimit dhe stafin përgjegjës duke u fokusuar fillimisht në fushat të rëndësishme më të madhe. Një monitorim i progresit në baza të rregullta, është i nevojshëm.			x

Çështja 4 Dobësitë në kontrollet e menaxhmentit të lartë – Prioritet i Lartë	Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të praktikave aktuale të raportimit dhe të përcaktojë kërkesat për raportim financiar cilësor tek menaxhmenti i lartë, për të siguruar një menaxhim efektiv të veprimtarisë. të një zgjidhja duhet të paraqitet deri më 1 tetor 2015.	x		
Çështja 5 Ekzekutim i ulët i buxhetit – Prioritet i Lartë	Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të inicojë një vlerësim sistematik të shkaqeve që kanë çuar në një nivel të ulët të ekzekutimit të buxhetit vit pas viti. Kryetari duhet të përcaktojë mënyra praktike për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar.	x		
Çështja 6 Mbivlerësimi i investimeve kapitale – Prioritet i Lartë	Rekomandimi 6 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që të gjitha shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe se ato nuk do të jenë subjekt i keq-klasifikimit në PVF-të e vitit 2015.	x		
Çështja 7 Menaxhimi i të hyrave vetjake – Prioritet i Lartë	Rekomandimi 7 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të kryhet një analizë gjithëpërfshirëse për ngecjen në menaxhimin e të hyrave vetjake. Një zgjidhje duhet të ofrohet dhe të vendosen kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv të të hyrave vetjake.		x	

<p>Çështja 8 Dobësi në shpenzimet përmes prokurimit – Prioritet i Lartë</p>	<p>Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet inicojë një rishikim të të gjitha proceseve të prokurimit që nga planifikimi e deri në ekzekutimin e pagesave. Plani i prokurimit duhet përgatitur në kohë, duke i përfshirë të gjitha projektet e planifikuara. Po ashtu, në rastet kur kërkohet, të gjitha kontratat duhet të lidhen përmes një procesi transparent të prokurimit publik.</p>	<p>x</p>		
<p>Çështja 9 Dobësi në menaxhimin e stafit – Prioritet i Mesëm</p>	<p>Rekomandimi 9 Kryetari duhet të ri-analizojë shkaqet e dështimit për ndarjen e detyrave dhe për angazhimin e paligjshëm të zyrtarëve me kontratë për shërbime të veçanta. Detyrat duhet të ndahen duke mos përzier rolet kyçe të zyrtarëve, ndërsa angazhimi i zyrtarëve me kontratë për shërbime të veçanta nuk duhet të përsëritet.</p>	<p>x</p>		
<p>Çështja 10 Dobësi në menaxhimin e subvencioneve – Prioritet i Mesëm</p>	<p>Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se Rregullorja për subvencione do të respektohet duke vendosur kritere dhe procedura të qarta që përputhen me objektivat e komunës. Kontrollat lidhur me këto kritere dhe procedura do të monitorohen për të parandaluar keqpërdorimin e fondeve nga përfituesit. Përfituesit që nuk dëshmojnë që shpenzimet janë bërë në përputhje me qëllimin e subvencionit, duhet të sanksionohen. Zgjidhjet e tilla të shpërndarjes nuk duhet të përdoren.</p>	<p>X</p>		

<p>Çështja 11 Nivel i lartë i llogarive të arkëtueshme – Prioritet i Lartë</p>	<p>Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet të ndërmarrë veprime adekuate për vlerësimin e saktë të llogarive të arkëtueshme. Këtë vlerësim duhet ta pasojë një qasje pro-aktive për mbledhjen e këtyre borxheve të pa arkëtuara. Kjo duhet të bëhet përmes një plani real që përcakton veprime dhe afate që qarta, e që duhet të monitorohet nga ana e Kryetarit.</p>			X
<p>Çështja 12 Mungesa e NjAB dhe Komitetit të Auditimit – Prioritet i Lartë</p>	<p>Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm vihet në funksion. Shërbime të rregullta të auditimit të brendshëm duhet të sigurohen qoftë nga jashtë apo përmes themelimit të NjAB-së brenda komunës. duhet të themelohet edhe Komiteti të Auditimit i cili do ta mbështeste menaxhmentin në eliminimin e mangësive dhe sigurimin e një mjedisi të shëndosh të kontrolleve të brendshme.</p>		X	